

Türkiye Diyanet İşleri Başkanlığı

KURBANI NËPËRMJET PYETJEVE

Titulli origjinal:

KURBAN REHBERI (Sorularla Kurban)

Nga turqishtja:

Rehan Neziri

Kreuzlingen, 2026

KURBANI

Që nga historia e hershme e njerëzimit, ibadeti i kurbanit ka qenë i pranishëm pothuajse në të gjitha fetë. Megjithatë, në Islam ai paraqet dallime të rëndësishme si nga forma, ashtu edhe nga qëllimi. Në Kur'an përmendet se dy bijtë e Ademit a.s. i paraqitën Allahut kurbanet e tyre (el-Maideh, 5:27), ndërsa në një ajet tjetër bëhet me shenjë se dispozita e kurbanit është caktuar në të gjitha fetë hyjnore (el-haxh, 22:34).

Kurbani është një ibadet që sjell dobi të shumta si për individin, ashtu edhe për shoqërinë. Duke therur kurban, njeriu i nënshtrohet urdhrit të Allahut dhe e shfaq gjallërisht vetëdijen e tij të shërbimit dhe bindjes ndaj Tij. Besimtarët, në çdo therje kurbanit, e rikujtojnë sprovën e suksesshme të Ibrahimit a.s. dhe birit të tij Ismailit a.s. në bindjen e plotë ndaj urdhrit të Allahut të Madhëruar, duke treguar simbolikisht se edhe vetë janë të gatshëm për një nënshtrim të tillë.

Kurbani e mban gjallë frymën e vëllazërisë, ndihmës së ndërsjellë dhe solidaritetit në shoqëri, si dhe kontribuon në realizimin e drejtësisë sociale. Sidomos në mjediset ku ka njerëz të varfër që nuk kanë fare ose kanë shumë pak mundësi të blejnë mish, ky rol i kurbanit bëhet edhe më i dukshëm.

Kurbani ia jep të pasurit kënaqësinë dhe shprehinë e shpenzimit të pasurisë në rrugën e fitimit të kënaqësisë së Allahut, të solidaritetit dhe të ndarjes me të tjerët. Ai e çliron njeriun nga sëmundja e koprracisë dhe nga lidhja e tepruar pas pasurisë së kësaj bote. Ndërsa të varfrit arrijnë që, nëpërmjet besimtarëve të pasur, ta falënderojnë Allahut, të largohen nga pesimizmi dhe armiqësia lidhur me shpërndarjen e begative në tokë dhe ta ndiejnë veten si pjesë të shoqërisë së tyre.

Kurbani është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e ibadetit të haxhit, i cili është një nga themelet e Islamit. Në një kohë kur miliona muslimanë në Arafat, të zhveshur nga lidhjet e kësaj bote dhe thuajse të mbështjellë me qefin të bardhë, qëndrojnë para Zotit të tyre, i ngrenë duart dhe luten për mëshirë për mbarë njerëzimin, edhe ata që nuk ndodhen atje përpiqen të arrijnë një lartësi shpirtërore në atmosferën e ibadetit të kurbanit dhe ta kërkojnë afërsinë me Zotin e tyre. Sepse kurbanit është kërkimi i afërsisë me Allahun, me çdo gjë të lartë e hyjnore, me të drejtën, me të vërtetën, me të mirën, me të drejtën dhe me të bukurën.

Kurbani është simbol i dashurisë, i besnikërisë, i sinqeritetit dhe i sakrificës. Në të gjendet një botë e thellë ku ndërthuret dashuria baba-bir e Ibrahimit dhe Ismailit a.s. me ndjenjën e përkushtimit ndaj së vërtetës dhe ndaj Allahut xh.sh.

KURBANI NËPËRMJET PYETJEVE

1) Çfarë është kurban?

Fjala *kurban* në kuptimin leksikor nënkupton “afrimin” dhe “atë që bëhet mjet për t’iu afruar Allahut”. Ndërsa si term fetar, kurban nënkupton therjen, sipas rregullave të caktuara, të një kafshe që i plotëson kushtet përkatëse, me qëllim adhurimi, për t’iu afruar Allahut dhe për ta fituar kënaqësinë e Tij; po ashtu, kjo fjalë përdoret edhe për vetë kafshën e therur për këtë qëllim.

Kurban që theret gjatë Bajramit të Kurbanit quhet *ud’hije*, ndërsa kurban që theret në haxh quhet *hedj*.

2) Cila është dispozita fetare e kurbanit?

Sipas shumicës së medh’hebeve (shafi, maliki dhe hanbeli), therja e kurbanit *ud’hije* është sunet. Ndërsa në medh’hebin hanefi, mendimi i preferuar është se kurban është vaxhib.

Kurban - pavarësisht dispozitës juridiko-fetare - është një nga ibadetet që konsiderohet simbol dhe shenjë dalluese e shoqërive muslimane dhe prej shekujsh zë një vend të rëndësishëm sidomos në jetën fetare të popullit tonë. Ai është një shenjë që tregon se muslimani, kur të jetë e

nevojshme, është i gatshëm ta sakrifikojë gjithë qenien dhe pasurinë e tij në rrugën e Allahut xh.sh.

3) Cila është baza fetare e kurbanit?

Kurbanit është një ibadet i vërtetuar me Kur'an (es-Saffat, 37:107; el-haxh, 22:28, 34, 36, 37), me praktikën e Muhammedit (s.a.v.s.) dhe me pajtimin e dijetarëve islamë.

Në transmetimet që gjenden në burimet autentike të hadithit, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë se në ditët e Kurban-Bajramit ibadeti më i dashur tek Allahu xh.sh. është therja e kurbanit; se kurbanit, sapo të theret, pranohet menjëherë tek Allahu xh.sh.; dhe se çdo pjesë e kafshës së kurbanit, madje edhe brirët dhe thundrat e saj, do të regjistrohen si vepra të mira për njeriun. Për këtë arsye, ai ka këshilluar që ky ibadet të kryhet vetëm për hir të Allahut xh.sh.

4) Kush është i obliguar të therë kurban?

Çdo musliman që është me mendje të shëndoshë, e ka arritur moshën e pubertetit, posedon pasuri në masën që konsiderohet i pasur sipas fesë dhe është vendës (jo udhëtar), është i obliguar të therë kurban.

Njeriu që i posedon të gjitha këto cilësi duhet të therë kurban si shenjë falënderimi ndaj Allahut xh.sh. për

begatitë që ia ka dhuruar dhe si dëshmi e gatishmërisë për sakrificë në rrugën e Allahut xh.sh.

5) Kush konsiderohet i pasur sipas kritereve fetare?

Sipas fesë, i pasur konsiderohet ai person që, përveç nevojave themelore dhe borxheve të tij, zotëron 80.18 gram ar ose pasuri, para apo mallra në vlerën e tij, qofshin ato pasuri që shtohen ose jo.

6) A mund të therin kurban gratë?

Në therjen e kafshës, personi që i plotëson kushtet dhe e ka aftësinë e nevojshme mund të therë kurban, qoftë grua apo burrë.

7) Nëse burri dhe gruaja në familje janë të pasur, a duhet secili prej tyre të therë veçmas kurban?

Te ibadetet, përgjegjësia, dhe si rrjedhojë edhe shpërblimi apo dënimi, janë individuale. Në Islam, mes anëtarëve të familjes nuk zbatohet parimi i pasurisë së përbashkët, por ai i pasurisë së ndarë. Nëse pasuria e burrit, e gruas dhe e fëmijëve të rritur është e përcaktuar veçmas, atëherë secili është pronar i pasurisë së vet.

Prandaj, nga anëtarët e familjes - burri, gruaja dhe fëmijët e rritur - kushdo që, përveç borxheve dhe nevojave themelore, zotëron 80.18 gram ar (20 mithkal) ose para e

pasuri në vlerën e tij, edhe nëse nuk janë pasuri që shtohen, konsiderohet i pasur sipas fesë.

Sipas këtyre kushteve, secili prej anëtarëve të familjes që konsiderohet i pasur fetarisht, ashtu siç është i obliguar ta japë sadakanë e fitrit, sipas medh'hebit hanefi është i obliguar të therë kurban me rastin e Kurban-Bajramit.

Ndërsa sipas medh'hebit shafi, therja e një kurbanit për të gjithë familjen është *sunet kifaje* – pra, sunnet kolektiv. Prandaj, nëse njëri nga anëtarët e familjes ther kurban, suneti konsiderohet i përmbushur për të gjithë familjen.

8) A mund të theret kurban në emër të një personi të vdekur?

Në fenë tonë nuk ekziston një lloj kurbanit i quajtur “kurban për të vdekurin” ose “kurban varri”. Megjithatë, mund të theret kurban me nijetin që sevapi i tij t'i dhurohet një të vdekuri.

Po ashtu, nëse një person ka pasur detyrim për kurban dhe gjatë jetës ka lënë porosi (*vasijet*) për këtë, atëherë, nëse pasuria që ka lënë ai mjafton, trashëgimtarët duhet ta zbatojnë porosinë e tij.

Transmetohet nga tabi'ini Hanesh se ka thënë:

“E pashë Ali ibn Ebi Talibin (r.a.) duke therur dy desh si kurban dhe e pyeta: ‘Çfarë është kjo?’ Ai u përgjigj: ‘Muhammedi (s.a.v.s.) sa ishte gjallë më pati porositur që

të ther kurban në emër të tij. Prandaj unë po ther kurban për të.”

Në këtë transmetim, Aliu (r.a.) e ka përmendur si arsye për therjen e kurbanit faktin që Pejgamberi (s.a.v.s.) ia kishte lënë këtë porosi. Prandaj, ky hadith nuk tregon se duhet therur kurban për të vdekurin nëse ai nuk ka lënë porosi.

Sipas kësaj, nëse i vdekuri nuk ka lënë *vasijet* (porosi), trashëgimtarët nuk janë të obliguar të therin kurban për të. Megjithatë, njeriu mund të japë sadaka për institucione bamirëse, për të varfër e nevojtarë, ose të therë kurban me qëllim që sevapin t’ua dhurojë prindërve të vdekur apo të afërmve të tjerë.

Nëse i vdekuri nuk ka lënë porosi për therje kurban në emrin e tij, personi që e ther mund që mishin e atij kurban t’ua shpërndajë të varfërve, por mund ta hajë edhe vetë, si dhe mund t’u japë edhe të pasurve. Por nëse ekziston *vasijeti* i të vdekurit, atëherë mishi duhet t’u shpërndahet ose t’u jepet plotësisht të varfërve.

9) A duhet të therë kurban personi që ka borxhe?

Kurbani është vaxhib për personin që, përveç nevojave të domosdoshme dhe borxheve të tij, zotëron një sasi të caktuar pasurie. Me hadithin e tij që përmban shprehje të rënda ndaj atyre që kanë mundësi, por nuk therin kurban (Ibni Maxhe, Edahi, 2), Muhammedi (s.a.v.s.) nga njëra anë ka treguar se ibadeti i kurbanit varet nga mundësia dhe

fuqia materiale, ndërsa nga ana tjetër ka bërë me dije se ai që ka mundësi duhet të thërë kurban.

Prandaj, për të qenë i obliguar me këtë ibadet, kërkohet një gjendje e caktuar financiare. Nëse personi, edhe pse ka borxhe, pas shlyerjes së tyre dhe pas mbulimit të nevojave themelore, ende zotëron pasuri në masën e *nisabit* (pragu prej kur njeriu quhet i pasur fetarisht = 80.18 gram ar ose pasuri, para apo mallra në vlerën e tij), ai duhet të thërë kurban. Mirëpo, nëse pasuria e tij nuk e arrin këtë masë, pasi të ndahen mjetet për nevojat bazë dhe borxhet, atëherë ai nuk është i obliguar të thërë kurban.

10) A lejohet blerja e kurbanit me kartë krediti?

Personi që është i obliguar të thërë kurban mund ta paguajë kafshën që do ta blejë si me para në dorë, ashtu edhe me pagesë të shtyrë ose me këste. Në këtë kuptim, pagesa e çmimit me kartë krediti nuk e pengon vlefshmërinë e kurbanit.

Megjithatë, borxhi i kartës së kreditit duhet të paguhet në kohën e caktuar dhe të shmanget hyrja në kamatë për shkak të vonesës së pagesës.

Në rastin kur kurbanit blihet me këste përmes kartës së kreditit dhe banka merr një pagesë shtesë për mundësinë e kësteve, kurbanit mbetet i vlefshëm, por për shkak të transaksionit me kamatë bëhet fjalë për një gjynah më vete.

11) A mund të blihet kurban me këste?

Shitja me *vade* (pagesë të shtyrë) është e lejuar. Këstet nënkuptojnë shtyrjen e pagesës së borxhit në disa afate të caktuara kohore. Prandaj, pasi që blerësi bëhet pronar i mallit të blerë me këste, nuk ka asnjë pengesë që një kafshë e blerë në këtë mënyrë të theret si kurban.

12) A mund të theret kurban me kredi bankare?

Personi që ther kurban, qoftë për shkak se është vaxhib apo si ibadet vullnetar, mund ta blejë kurbanin si me pagesë në dorë, ashtu edhe duke marrë borxh. Kjo nuk e pengon vlefshmërinë e kurbanit.

Mirëpo, nëse për marrjen e kredisë duhet të paguajë kamatë, atëherë ai bie në gjynah për shkak të ndalesës së dhënies së kamatës. Për këtë arsye, është më e përshtatshme që personi me gjendje të dobët financiare të mos u drejtohet metodave të tilla për të therur kurban.

13) A është kusht të jesh me abdest gjatë therjes së kurbanit?

Nuk është kusht që personi që ther kurban të jetë me abdes. Megjithatë, meqë kurban i është një ibadet, është më e vlefshme që therësi të jetë me abdest.

14) A mund të theret kurbanit pasi kafsha të jetë trullorur?

Nuk ka pengesë që kafsha e kurbanit, në rast nevojë ose për të mos e munduar atë, të trulloset me metoda të përshtatshme teknike para therjes, me kusht që të mos ngordhë para therjes.

Mirëpo, nëse kafsha ngordh nga efekti i trullorjes para se të theret, ajo nuk vlen si kurban dhe mishi i saj nuk lejohet të hahet.

15) Kur fillon dhe kur mbaron koha e therjes së kurbanit?

Koha e therjes së kurbanit, në vendet ku falet namazi i Bajramit, fillon pas faljes së namazit të Bajramit; ndërsa në vendet ku nuk falet namazi i Bajramit, atje fillon pas hyrjes së kohës së namazit të sabahut (pas agimit).

Sipas medh'hebit hanefi, kjo kohë vazhdon deri në mbrëmjen (akshamin) e ditës së tretë të Bajramit. Ndërsa sipas medh'hebit shafi, kurbanit mund të theret edhe në ditën e katërt.

Brenda kësaj periudhe, kurbanit mund të theret si natën, ashtu edhe ditën. Megjithatë, është më e përshtatshme të theret gjatë ditës. Më me vlerë është që therja të bëhet në ditën e parë të Bajramit.

16) Çfarë duhet pasur kujdes gjatë therjes së kurbanit?

Gjatë therjes së kurbanit duhet t'u kushtohet kujdes këtyre çështjeve:

a. Që therja të jetë e vlefshme sipas rregullave, duhet të priten gryka e ushqimit, gryka e frymëmarrjes dhe të paktën njëra nga dy arteriet kryesore të kafshës. Gjatë një therjeje të tillë, prerja e palcës kurrizore të kafshës konsiderohet *mekruh* (e papëlqyeshme). Në këtë aspekt nuk ka dallim mes therjes për mish dhe therjes së kurbanit.

b. Duhet pasur kujdes që koka e kafshës të mos ndahet nga trupi para se t'i dalë shpirti.

c. Kafshës që do të bëhet kurban nuk duhet t'i shkaktohet dhimbje apo mundim. Për këtë arsye, kafshët duhet të theren nga persona të aftë dhe procesi i therjes duhet të kryhet në mënyrë të shpejtë.

ç. Duhet të merren masat e nevojshme për pastërtinë e ambientit.

d. Gjithashtu, duhet treguar kujdes maksimal që kafshët të mos mbahen pranë njëra-tjetrës dhe që njëra ta shohë therjen e tjetrës.

17) Cila është dispozita e përmendjes së emrit të Allahut xh.sh., e thënies së "Besmeles", gjatë therjes së kurbanit? Cilat dua lexohen?

Qoftë kur kafsha theret me nijetin e kurbanit apo për ndonjë qëllim tjetër, gjatë therjes duhet të thuhet Besmeleja. Nëse Besmeleja lihet qëllimisht pa u thënë gjatë therjes, sipas medh'hebit hanefi mishi i asaj kafshe nuk lejohet të hahet. Mirëpo, nëse lihet pa dashje ose nga harresa, mishi i saj lejohet të hahet.

Në medh'hebin shafi, thënia e Besmeles konsiderohet *mustehab* (e pëlqyeshme) dhe, nëse lihet, nuk shihet pengesë në ngrënien e mishit.

Gjatë therjes së kurbanit thuhet tri herë:

"Bismil-lahi Allahu ekber." (Në emër të Allahut, Ai është më i Madhërishmi).

Pastaj lexohen këto ajete nga Kur'ani:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ . لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُسْلِمِينَ .

"Thuaj: Me të vërtetë namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam prej muslimanëve të parë." (el-En'am, 6:162-163)

Pastaj lexohet edhe ky ajet nga Kur'ani:

إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلدِّي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ.

“Unë, duke qenë i përqendruar në të vërtetën, e kam kthyer fytyrën time drejt Atij që krijoi qiejt dhe tokën dhe nuk jam prej atyre që i bëjnë ortak Allahut.” (el-En‘âm, 6:79)

18) Cila është dispozita fetare e tekbireve të teshrikut, kush i thotë ato, dhe kur?

Ekzistojnë transmetime se Muhammedi (s.a.v.s.) i ka bërë *tekbiret e teshrikut* (të thuhet: *La ilahe il-lallahu vallahu ekber. Allahu ekber ve lil-lahil-hamd*) pas namazeve farz, duke filluar nga namazi i sabahut në ditën e Arafatit deri në namazin e ikindisë së ditës së katërt të Kurban-Bajramit, duke e përfshirë edhe ikindinë e asaj dite.

Sipas mendimit të preferuar në medh’hebin hanefi, nga sabahu i ditës së Arafatit deri në ikindinë e ditës së katërt të Bajramit, gjithsej për 23 kohë namazi, pas çdo namazi farz është vaxhib që çdo musliman, burrë apo grua, t’i thotë *tekbiret e teshrikut*.

Nëse gjatë ditëve të *teshrikut* ka mbetur ndonjë namaz pa u falë, kur të bëhet ai *kaza* (kompensohet më vonë), bashkë me të *kaza* bëhen edhe *tekbiret e teshrikut*. Por, nëse namazi *kaza* falet pasi të kenë kaluar ditët e *teshrikut*, atëherë *tekbiret* nuk thuhën. *Tekbiret* nuk bëhen *kaza* nëse vetë namazi nuk falet *kaza*.

Ndërsa sipas medh’hebit shafi, *tekbiret e teshrikut* janë sunet.

19) A është hallall kurban i therur nga një person që nuk është prej Ehli-Kitabëve?

Që mishi i kafshëve të lejuara për ngrënie të jetë hallall, personi që e ther kafshën duhet të jetë me mendje dhe aftësi dalluese të shëndoshë, si dhe të jetë musliman ose prej Ehli-Kitabëve (d.m.th. i krishterë ose hebre).

Mishi i kafshës së therur nga një mexhusi, idhujtar apo ateist, nuk është hallall. Po ashtu, kafsha e therur prej tij nuk vlen si kurban.

20) Cila është dispozita e faljes së namazit të falënderimit pas therjes së kurbanit? Si falet ky namaz?

Në thelb, nuk ekziston një namaz i veçantë me emrin “namazi i kurbanit”. Megjithatë, njeriu mund të falë namaz *nafile* (vullnetar) sa të dëshirojë, qoftë me një shkak të caktuar apo pa shkak, me kusht që falja e namazit *nafile* të mos bëhet në kohët kur është mekruh falja e çfarëdo lloji namazi (gjatë lindjes së diellit, kur dielli ndodhet në zenit dhe gjatë perëndimit të diellit).

Edhe personi që ther kurban, duke qenë se e ka arritur mundësinë për ta kryer këtë ibadet, mund të falë dy rekate namaz *nafile* si falënderim ndaj Allahut xh.sh. për begatinë e dhënë - me kusht që të mos besojë apo mendojë se ky namaz është një detyrim fetar i veçantë.

21) A ekziston në fenë tonë vendosja e gjakut të kurbanit në ballë?

Vendosja me gisht e gjakut të kurbanit në ballë nuk ka asnjë lidhje me fenë. Në asnjë nga burimet e besueshme nuk ekziston një mësim i tillë. Kuptohet se kjo praktikë ka hyrë ndër popull nga kultura të tjera.

22) Si duhet të vlerësohet mishi i kurbanit?

Dijetarët islamë kanë rekomanduar që mishi i kurbanit të ndahet në tri pjesë: një pjesë t'u shpërndahet të varfërve që nuk kanë mundësi të therin kurban, një pjesë t'u jepet të afërmeve, miqve dhe fqinjëve, ndërsa një pjesë të mbahet për familjen.

Nëse familja është e varfër, i gjithë mishi mund të mbahet në shtëpi. Mirëpo, në periudha kur numri i nevojtarëve në shoqëri rritet, është më e përshtatshme që muslimanët me gjendje të mirë ekonomike ta shpërndajnë pjesën më të madhe, madje edhe të gjithë mishin e kurbanit për nevojtarët.

23) A mund të përfshihen ortakë të tjerë në një kafshë të blerë për kurban?

Kafshët e mëdha mund të bëhen kurban nga një deri në shtatë persona ortakë. Një kafshë e tillë mund të blihet që në fillim me ortakëri deri në shtatë veta, por edhe pasi të jetë blerë apo nëse dikush tashmë posedon një kafshë të

madhe, mund të përfshihen ortakë të tjerë, me kusht që numri i tyre të mos kalojë shtatë veta.

Për këtë është e nevojshme që të gjithë ortakët të jenë dakord.

Nga Ebu Hanife është transmetuar edhe një mendim tjetër në këtë çështje. Për këtë arsye, për t'u shmangur nga mospajtimet, është më mirë që ortakët të përcaktohen qartë që në momentin e blerjes së kafshës për kurban.

24) A lejohet t'i jepet pagesë kasapit që e ther kurbanin? A mund t'i jepet një pjesë e mishit si pagesë për therjen?

Vetë procesi i therjes së kafshës nuk është ibadet. Për këtë arsye, lejohet që kasapi që e ther kurbanin të marrë pagesë për punën e tij. Mirëpo, pagesa e tij nuk duhet të jepet nga mishi i kurbanit. Sepse, nëse veprohet kështu, një pjesë e barrës materiale që kërkohet për kryerjen e ibadetit të kurbanit do të mbulohej nga vetë kurbanit.

Është transmetuar se Ali ibn Ebi Talibi (r.a.) ka thënë:

“Muhammedi (s.a.v.s.) më urdhëroi të qëndroja pranë deveve gjatë therjes së tyre, t'ua shpërndaja lëkurat dhe mbulesat që kishin mbi shpinë të varfërve, dhe më ndaloj që ndonjë prej tyre t'ia jepja kasapit si pagesë. Pastaj tha: ‘Pagesën e kasapit do t'ia japim ne vetë.’”

25) Si duhet të vlerësohet lëkura e kurbanit?

Lëkura e kurbanit duhet t'i jepet një të varfri ose një institucioni bamirësie. Muhammedi (s.a.v.s.), gjatë haxhit të Lamtumirës, e urdhëroi Ali ibn Ebi Talibin (r.a.) që të qëndronte pranë deveve të therura si kurban dhe t'i shpërndante si sadaka lëkurat dhe mbulesat e tyre, duke e ndaluar që ndonjë pjesë prej tyre t'i jepej kasapit si pagesë.

Prandaj, nuk lejohet që lëkurat e kurbanit të shiten për para ose të përdoren si pagesë për therjen apo kujdesin ndaj kafshës. Nëse lëkura shitet, atëherë vlera e saj duhet t'u jepet të varfërve.

Megjithatë, nuk ka pengesë që lëkura e kurbanit t'i dhurohet një të varfri ose një organizate bamirësie, apo të përdoret në shtëpi për të bërë sexhade, sende shtëpiake dhe gjëra të ngjashme.

26) A përmbushet ibadeti i kurbanit duke dhënë sadaka në vend të therjes së tij?

Ibadetet, ashtu siç e kanë formën, kushtet dhe pjesët përbërëse të tyre, i kanë gjithashtu edhe urtësitë, qëllimet dhe arsyet e ligjësimin të tyre. Nuk është e mundur që këto veçori të mendohen të ndara nga njëra-tjetra.

Çdo ibadet e ka mënyrën e vet të kryerjes. Therja e kafshës është shtylla kryesore e kurbanit. Prandaj, ibadeti i kurbanit mund të realizohet vetëm duke e therur, sipas rregullave, kafshën që i plotëson kushtet për kurban.

Vetëm dhënia e vlerës së tij si sadaka nuk e zëvendëson ibadetin e kurbanit.

Edhe Muhammedi (s.a.v.s.), pasi kurbanit u bë i ligjësuar, e ka kryer këtë ibadet çdo vit duke therur vetë kurban.

Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë se në ditët e Kurban-Bajramit ibadeti më i dashur tek Allahu xh.sh. është therja e kurbanit; se kurbanit pranohet tek Allahu xh.sh. sapo të theret dhe se çdo pjesë e kafshës së kurbanit regjistrohet si vepër e mirë për njeriun.

Sigurisht, ndihma pa kundërshtim ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, si dhe bamirësia e mirësia me synimin për ta fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, janë detyra shumë të rëndësishme të muslimanit. Madje, ndihma ndaj atij që gjendet në nevojë jetike konsiderohet farz në fenë tonë.

Megjithatë, nuk është e drejtë që këto dy ibadete (kurbanit dhe sadakaja) të paraqiten si alternativa të njëra-tjetrës. Për këtë arsye, dhënia e kafshës si sadaka pa e therur, nuk e zë vendin e kurbanit. Po ashtu, edhe dhurimi i vlerës së kurbanit të varfërve ose organizatave bamirëse nuk e përmbush ibadetin e kurbanit.

27) Çfarë cilësish duhet të ketë kafsha që do të bëhet kurban?

Kafsha e kurbanit duhet t'i ketë mbushur këto mosha: deveja: pesë vjet, gjedhi (lopa dhe bualli): dy vjet, delja dhe dhia: një vit.

Përveç kësaj, nëse delja gjashtë muajshe, që për nga shëndeti dhe pamja duket si një dele njëvjeçare, ajo mund të bëhet kurban. Sipas medh'hebit shafi, edhe dhia duhet t'i ketë mbushur dy vjet.

Është me rëndësi, si nga aspekti i ibadetit ashtu edhe nga ai shëndetësor, që kafsha e kurbanit të jetë e shëndoshë, me gjymtyrë të plota dhe e majme. Për këtë arsye, nuk vlejnë për kurban kafshët që janë: të sëmura rëndë deri në masën e gjymtimit, tepër të dobëta dhe të rraskapitura, të verbra në njërin ose të dy sytë, me një ose të dy brirët të thyer nga rrënja, me gjysmën e gjuhës, bishtit, veshëve ose gjinjve të prerë, ose që i kanë rënë të gjitha apo shumica e dhëmbëve.

Megjithatë, nuk ka pengesë që të bëhet kurban një kafshë që: ka lindur pa brirë, është pak e shtrembër në sy, çalon lehtë, është pak e sëmurë, e ka veshin të çarë ose të shpuar, ose i mungon një pjesë e gjinjve.

Në medh'hebin shafi, të metat që e dëmtojnë mishin, dhjamin ose organet e brendshme të kafshës e pengojnë edhe vlefshmërinë e kurbanit.

Në përgjithësi, ashtu siç të metat e përmendura më sipër e pengojnë një kafshë të bëhet kurban, po ashtu nuk lejohet të bëhen kurban edhe kafshët me zgjebe, si dhe ato të cilave u kanë rënë dhëmbët në atë masë sa që nuk mund të ushqehen normalisht.

28) A vlejnë për kurban kafshët me vesh të prerë ose të shpuar?

Që një kafshë të vlejë për kurban, ajo nuk duhet ta ketë ndonjë të metë që konsiderohet mangësi sipas zakonis të njerëzve. Muhammedi (s.a.v.s.) ka kërkuar që gjatë zgjedhjes së kurbanit t'u kushtohet vëmendje syve dhe veshëve të kafshës.

Prandaj, kafsha së cilës i është prerë më shumë se gjysma e veshit nuk është e përshtatshme për kurban. Nëse njëri vesh është i shpuar ose i çarë, atëherë: nëse shpimet ose çarjet përbëjnë më shumë se gjysmën e veshit, kafsha e tillë nuk mund të bëhet kurban; ndërsa prerjet, shpimet ose çarjet që nuk e arrijnë këtë masë, nuk e pengojnë vlefshmërinë e kurbanit.

29) A mund të bëhen kurban kafshët që kanë lindur pa brirë, që u janë thyer brirët ose që u janë djegur brirët me rrymë elektrike pas lindjes?

Të metat që e pengojnë vlefshmërinë e kurbanit janë ato mangësi që e ulin vlerën e kafshës në krahasim me kafshët e ngjashme me të. Heqja e një pjese të bishtit në mënyrë të padëmshme për zhvillim më të mirë të kafshës, apo mpirja dhe pengimi i rritjes së brirëve me ndërhyrje të posaçme, nuk konsiderohen mangësi që e ulin vlerën e saj.

Prandaj, ashtu siç lejohet të bëhen kurban kafshët që kanë lindur pa brirë, po ashtu nuk ka pengesë që të bëhen kurban edhe kafshët të cilave, që në moshë të vogël, u janë

hequr brirët, u janë djegur me rrymë elektrike ose me metoda kimike, apo janë bërë pa brirë me ndërhyrje të ngjashme.

30) A mund të bëhen kurban delet pa bisht ose me bisht të prerë?

Nuk ka pengesë që të bëhen kurban delet që kanë lindur pa bisht ose atyre që, në moshë të vogël, u është hequr bishti për t'u majmur më mirë.

Mirëpo, nuk lejohet të bëhet kurban kafsha së cilës, si pasojë e një aksidenti ose dëmtimi, i është këputur i gjithë bishti ose më shumë se gjysma e tij në atë mënyrë që ia ul vlerën.

31) A mund të bëhen kurban kafshët e tredhura?

Kafshët që janë tredhur ose sterilizuar për qëllime të ndryshme mund të bëhen kurban. Nga aspekti i kurbanit, kjo gjendje nuk përbën asnjë mangësi.

32) A mund të bëhet kurban kafsha që ka të meta në gjinjtë e saj?

Të metat që e zhdukin plotësisht dobinë e pritur nga kafsha ose që ia prishin dukshëm pamjen, e pengojnë atë të vlejë për kurban. Prandaj, kafsha së cilës i mungon gjysma e gjinjve, qoftë që nga lindja apo si pasojë e mëvonshme, nuk vlejnë si kurban.

Po ashtu, nuk vlejnë si kurban edhe kafshët të cilave, për shkak të ndonjë sëmundjeje, u është ndërprerë qumështi në gjysmën e gjinjve. Mirëpo, nëse qumështi është ndërprerë pa ndonjë sëmundje, atëherë nuk ka pengesë që kafsha të bëhet kurban.

33) Cilat pjesë të kurbanit nuk lejohen të hahen? Çfarë duhet bërë me këto organe?

Te kafshët, mishi i të cilave është hallall për ngrënie - qofshin therur si kurban apo për ndonjë qëllim tjetër - ngrënia e gjakut, tëmthit, gjëndrave, fshikëzës së urinës, organeve gjenitale dhe testikujve është *mekruh tahrimen* (e papëlqyeshme afër haramit).

Sa u përket pjesëve që nuk hahen të kurbanit ose të një kafshe tjetër të therur, është më e përshtatshme që ato të varrosen në tokë për arsye të higjienës dhe ruajtjes së pastërtisë së ambientit. Megjithatë, me kusht që të mos ndotet mjedisi, ato mund t'u jepen edhe kafshëve si macet dhe qentë.

34) A mund të përfitojë njeriu nga qumështi ose fuqia e një kafshe që e ushqen dhe ka vendosur ta bëjë kurban?

Nëse dikush vendos që një kafshë të cilën e ushqen dhe e rrit në shtëpinë e tij ta therë si kurban, ai mund të përfitojë nga fuqia e saj, ose, nëse është femër, nga qumështi i saj.

Mirëpo, nuk është e përshtatshme, para se të theret, të përfitohet nga qumështi ose leshti i një kafshe që është blerë posaçërisht si kurban. Sepse, në këtë rast, kafsha është caktuar si kurban që nga momenti i blerjes.

Nëse megjithatë është përfituar prej saj, atëherë vlera e këtij përfitimi duhet të jepet sadaka.

35) A është i obliguar personi që e kryen haxhin të therë kurban edhe në vendlindjen e tij?

Ekziston pajtim se personi që është në ihram për haxh dhe ndodhet në Mekë si udhëtar (*seferi*), nuk është i obliguar me kurbanin *ud'hije*. Ndërsa nëse nuk konsiderohet udhëtar, mes dijetarëve hanefi ka mospajtim lidhur me atë nëse kurbanin *ud'hije* është vaxhib apo jo.

Sipas mendimit që preferohet sot, personi që ndodhet në haxh, qoftë udhëtar apo jo, nuk është i obliguar të therë kurban. Edhe praktika aktuale është në këtë drejtim.

Megjithatë, nuk ka asnjë pengesë që personi që konsiderohet udhëtar të therë kurban, qoftë vetëm apo së bashku me banorët vendas.

Ndërsa sipas medh'hebit shafi, kurbanin *ud'hije* është *sunet muekede* (sunnet i fuqishëm) për çdo person që ka mundësi, pa marrë parasysh nëse është udhëtar apo jo, apo nëse ndodhet në haxh apo jo.

36) A mund të bëhen ortakë në të njëjtën kafshë të madhe për *akika*, kurban të zotuar, *ud'hije* dhe kurban nafile?

Në kurbanet që theren me ortakëri, nuk është kusht që të gjithë ortakët ta kenë të njëjtin qëllim për kurbanin. Mjafton që secili prej ortakëve të marrë pjesë me nijetin e ibadetit. Prandaj, disa mund ta bëjnë nijetin për kurban *ud'hije*, të tjerë për kurban të zotuar (*nedhr*), për *akika* (pas lindjes së fëmijës) ose për kurban nafile.

Ndërsa sipas medh'hebit shafi, nuk është e nevojshme që të gjithë ortakët të hyjnë me nijetin e kurbanit. Disa mund të marrin pjesë me nijetin e kurbanit, ndërsa të tjerët për të ngrënë mish, për ta shitur mishin apo për qëllime të ngjashme.

37) A mund të blihet kafsha e kurbanit sipas peshës?

Kafsha e kurbanit mund të blihet dhe të shitet duke u peshuar e gjallë dhe duke u përcaktuar çmimi sipas kilogramit.

Po ashtu, nëse në shoqëri ekziston një praktikë e përhapur që nuk çon në mashtrim, konfuzion apo mosmarrëveshje, kafsha që dëshirohet të blihet për kurban mund të shitet edhe në atë mënyrë që çmimi për kilogram i mishit të caktohet paraprakisht, ndërsa pagesa të bëhet pasi të theret kafsha dhe pasi të peshohet mishi.

Në parim, kjo mënyrë shitblerjeje nuk përputhet me qasjen e Ebu Hanifes, por sipas qasjes së dy nxënësve të tij

kryesorë (*imamejn* – Ebu Jusufi dhe Muhammedi), ajo mund të konsiderohet e lejuar. Sepse paqartësia në këtë lloj shitjeje - ku në momentin e kontratës dihet vetëm çmimi për kilogram, por jo pesha e saktë - mund të largohet nga vetë shitësi dhe blerësi.

Megjithatë, që kjo shitje të jetë e vlefshme: marrëveshja duhet të përfundojë para therjes, çmimi për kilogram i mishit duhet të përcaktohet qartë, dhe pas therjes pesha e mishit duhet të përcaktohet në mënyrë që të mos çojë në mashtrim ose mosmarrëveshje.

Gjithashtu, nuk duhet të vihet kusht që pjesë të caktuara të kurbanit, si koka, këmbët apo organet e brendshme, të mbeten për shitësin.

38) Çfarë duhet bërë nëse kafsha e blerë për kurban ngordh para therjes?

Nëse kafsha e blerë për kurban ngordh para se të theret, dispozita ndryshon sipas gjendjes ekonomike të personit që e ka blerë.

Nëse personi është i pasur, ai duhet ta blejë një tjetër dhe ta therë, sepse ende nuk e ka kryer kurbanin që e ka vaxhib.

Mirëpo, nëse është i varfër, nuk ka nevojë ta blejë një kafshë tjetër. Sepse kurbanin nuk është vaxhib për të varfrin; ai vetëm me blerjen e kafshës e kishte bërë obligim për veten therjen e asaj kafshe. Kur ajo ngordh, obligimi bie dhe nuk kërkohet të blejë një tjetër.

39) A është i obliguar udhëtari (*seferiu*) të therë kurban?

Udhëtari (*seferiu*) nuk është i obliguar të therë kurban. Megjithatë, nëse e ther, fiton shpërblimin e tij.

Njeriu mund ta therë kurbanin në vendin ku banon, por edhe në vendin ku ka shkuar për shkak të Bajramit ose për ndonjë arsye tjetër. Të qenit udhëtar nuk e pengon therjen e kurbanit dhe as pranimin e tij.

Nëse dikush ther kurban duke qenë *seferi* dhe gjatë ditëve të Bajramit kthehet në vendlindjen e tij, nuk ka nevojë të therë përsëri një kurban tjetër.

Po ashtu, nëse dikush në fillim të Kurban-Bajramit është banor vendas dhe më pas niset për udhëtim, kurbanit nuk bëhet vaxhib për të.

Ndërsa ai që në fillim të Bajramit është *seferi* dhe nuk ther kurban, por më pas kthehet në vendin e tij gjatë ditëve të Bajramit, ai duhet të therë kurban.

Sipas mendimit të atyre që e konsiderojnë kurbanin sunet - në krye me medh'hebin shafi - e njëjta rregull vlen edhe për udhëtarin.

40) A lejohet të bëhen kurban kafshët e mëdha të llojit të gjedhit që ende nuk i kanë mbushur dy vjet, por që u kanë dalë dy dhëmbët e përparmë?

Që kafshët e mëdha të llojit të lopës të vlejné për kurban, ato duhet të kenë mbushur të paktën dy vite hënore.

Prandaj, nëse dihet me siguri se një kafshë e tillë i ka mbushur dy vjet, fakti që nuk i kanë dalë ende dy dhëmbët e përparmë definitivë (*incisivi centrales*) nuk e pengon atë të vlejë për kurban.

Po ashtu, edhe nëse i kanë dalë këta dhëmbë, por kafsha ende nuk i ka mbushur dy vite hënore, ajo nuk mund të bëhet kurban.

Megjithatë, për kafshët e llojit të lopës, lindja e të cilave nuk dihet saktësisht, dalja e dy dhëmbëve të përparmë mund të merret si kriter për të vlerësuar nëse kafsha mund të bëhet kurban.

41) A lejohet të bëhet kurban kafsha shtatzënë?

Nuk është e përshtatshme që kafshët që kanë të vogël në bark të theren, qoftë si kurban apo për mish.

Megjithatë, nëse theret, ibadeti i kurbanit konsiderohet i përmbushur.

42) A mund të mblidhen para nga një grup njerëzish për të therur kurban në emër të Pejgamberit s.a.v.s.?

Në fenë tonë nuk ekziston një praktikë e tillë. Nuk është e drejtë që kjo të shihet si një ibadet i kërkuar. Sepse ta konsiderosh si ibadet një praktikë që nuk është transmetuar nga Allahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij, dhe t'i japësh asaj karakter fetar, është *bid'at* (risi e refuzuar).

Ndërsa çdo *bid'at*, sipas përshkrimit të Muhammedit (s.a.v.s.), është devijim.

Transmetimi nga Ali ibn Ebi Talibi (r.a.), ku thuhet: “Muhammedi (s.a.v.s.) më pati porositur që të ther kurban në emër të tij. Prandaj unë po ther kurban për të.”, nuk mund të merret si argument për një praktikë të tillë. Sepse Aliu (r.a.) e ka lidhur therjen e kurbanit me faktin që Pejgamberi (s.a.v.s.) ia kishte lënë këtë porosi. Prandaj, ky transmetim nuk tregon se duhet therur kurban për një të vdekur nëse ai nuk ka lënë *vasijet* për këtë.

43) Çfarë do të thotë kurban i zotuar (*nedhr*)?

Personi që zotohet të therë kurban është i obliguar ta përmbushë këtë zotim. Nëse ai e ka lidhur zotimin me realizimin e një kushti të caktuar, atëherë duhet ta therë kurbanin kur ai kusht të realizohet.

Nga mishi i kurbanit të zotuar nuk lejohet të hanë: vetë personi që e ka bërë zotimin, bashkëshorti ose bashkëshortja e tij, prindërit, gjyshërit dhe gjyshet e tij, si dhe fëmijët dhe nipërit apo mbesat e tij. Po ashtu, nga ky mish nuk duhet të hanë as të pasurit.

Nëse vetë personi ose ndonjëri prej këtyre që u përmendën sipër hanë nga ky mish, atëherë duhet t'ua japin të varfërve vlerën tregtare të mishit që e kanë ngrënë.

44) Çfarë do të thotë kurban i falënderimit?

Njeriu mund të therë një kurban falënderimi për shkak se e ka arritur një qëllim që e dëshironte ose e ka fituar një begati të caktuar. Megjithatë, nëse nuk ka bërë zotim për këtë, therja e kurbanit nuk është detyrim për të.

Po ashtu, sipas medh'hebit hanefi, kurban i që e therin në rrethin e Haremit të Mekës ata që e kryejnë haxh *temettu* ose *kiran*, për shkak se e kanë kryer së bashku haxhin dhe umren në të njëjtën periudhë kohore, konsiderohet një lloj kurban falënderimi.

45) Çfarë është kurban *akika*?

Kurban i që theret si shenjë falënderimi për lindjen e një fëmije quhet *akika*. Therja e kurbanit *akika* është sunet.

Transmetohet nga Abdullah ibni Abbasi (r.a.) se Muhammedi (s.a.v.s.) ka therur nga një kurban *akika* për Hasanin dhe Husejnin. Në një hadith tjetër ai ka thënë: “Çdo fëmijë është si peng i akikës së tij; në ditën e shtatë theret kurban i për të, i rruhet koka dhe i ngjitet emri.”

Prandaj, kurban i *akika* mund të theret që nga dita e lindjes së fëmijës e deri në arritjen e pubertetit, megjithëse më e vlefshme është të theret në ditën e shtatë pas lindjes.

Gjithashtu, është *mustehab* (e pëlqyeshme) që po atë ditë fëmijës t'i vihet emri dhe të jepet sadaka në vlerën e peshës së flokëve të tij në ar ose në kundërvlerën e saj.

46) A mund të theret kurbanin me autorizim (*vekâlet*)?

Kurbanin njeriu mund ta therë vetë, por mund edhe t'ia autorizojë dikujt tjetër ta therë në emrin e tij. Sepse kurbanin, ashtu si haxhi dhe zekati, është një ibadet që kryhet me pasuri; ndërsa në ibadetet që lidhen me pasurinë, autorizimi (*vekalet*) lejohet.

Është transmetuar se Ali ibn Ebi Talibi (r.a.) ka thënë: “Muhammedi (s.a.v.s.) më urdhëroi të qëndroja pranë deveve gjatë therjes së tyre, t'i shpërndaja lëkurat dhe mbulesat që kishin mbi shpinë, dhe më ndaloi që ndonjë pjesë prej tyre t'ia jepja kasapit si pagesë, duke thënë: ‘Pagesën e kasapit do ta japim ne vetë.’” (Buhariu, Haxh, 120–121)

Personi që e ther kurbanin me autorizim mund t'i japë autorizim dikujt në vendin ku ndodhet, por edhe një personi ose institucioni në një vend tjetër. Autorizimi mund të jepet me gojë ose me shkrim, si dhe përmes telefonit, internetit, e-mailit, faksit dhe mjeteve të ngjashme të komunikimit.

Personi ose institucioni që caktohet si përfaqësues duhet ta kryejë autorizimin e marrë në mënyrën më të rregullt dhe të përgjegjshme.